



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
i
SBS Select Bunkering Services – Adria SHA

KREU I

PËRKUFIZIME; FORMA; SELIA; EMRI; KOHËZGJATJA; OBJEKTI

Neni 1- Emri dhe përkufizime

1.1 Në këtë Statut:

“Filial”

është, në lidhje me një person, çdo shoqëri *holding*, shoqëri mëmë, filial, degë e shoqërisë ose çdo filial apo degë tjetër e shoqërisë së kësaj shoqërie *holding* ose shoqërie mëmë dhe çdo person tjetër që kontrollon, kontrollohet nga ose është në Kontrollin e përbashkët me këtë person.

“Statuti”

është ky akt themelimi apo statut i shoqërisë, i ndryshuar dhe zëvendësuar, rast pas rasti.

“Shoqëri e lidhur”

është, në lidhje me një person, çdo shoqëri *holding* në lidhje me të cilën ky person është një degë e zotëruar tërësisht dhe çdo degë tjetër e zotëruar tërësisht e kësaj shoqërie *holding*.

“Audituesit”

janë një a disa audituesit ligjorë të shoqërisë, të cilët emërohen kohë pas kohe.

“Këshilli”

është Këshilli i Administrimit të shoqërisë që formohet kohë pas kohe, në përputhje me nenin 154 e në vijim të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

“Anëtar i Këshillit”

është anëtari i Këshillit të Administrimit, kohë pas kohe, dhe “anëtarët e Këshillit” do të interpretohet sipas rastit.

“Mbledhja e Shtyrë e Këshillit”

ka kuptimin e dhënë në nenin 16.3.



SBS ADRIA SH.A.

SELECT BUNKERING SERVICES

**“Çështjet
e rezervuara të Këshillit”**

janë çështjet e përcaktuara në nenin 15.2 dhe në Shtojcë.

“Aktivitet tregtar”

ka kuptimin e dhënë në nenin 5.

“Ditë pune”

janë ditët me përjashtim të atyre të fundjavës (të shtunës e të dielës) dhe ditëve të festave zyrtare, kur bankat në Tiranë të Shqipërisë e në Hamburg të Gjermanisë janë të hapura për punë.

“Shoqëria”

është SBS Select Bunkering Services – Adria SHA

“Ligji për Shoqëritë Tregtare”

është ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar kohë pas kohe.

“Personi i lidhur”

është, në lidhje me çdo person (“Personi i Lidhur”):

(a) bashkëshorti/ja ose partneri/ja e personit të lidhur;

(b) çdo person tjetër (qoftë i së njëjtës gjini apo i gjinisë së kundërt) me të cilin personi i lidhur jeton si partner në një marrëdhënie të qëndrueshme familjare;

(c) fëmijët dhe fëmijët e bashkëshortit/es të personit të lidhur;

(d) çdo fëmijë ose fëmijë i bashkëshortit/es të një personi sipas paragrafit (b) (e që nuk është fëmijë i bashkëshortit/es të personit të lidhur), i cili jetojnë me personin e lidhur dhe i cili nuk e ka mbushur moshën 18 vjeç;


(e) prindërit e personit të lidhur;

(f) çdo person juridik:

- ku personi i lidhur dhe/ose personi sipas paragrafëve

(a) deri në (e), ka interes në aksionet që përbëjnë kapitalin aksionar të këtij personi juridik me një vlerë nominale të barabartë me të paktën njëzet për qind (20%) të tij; ose

- në lidhje me të cilin personi i lidhur dhe/ose personi sipas paragrafëve (a) deri në (e) ka të drejtë të ushtrojë ose kontrollojë ushtrimin e më shumë se njëzet për qind (20%)



SBS ADRIA SH.A.

SELECT BUNKERING SERVICES

“Kontrolli”

të së drejtës të votës në çdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme të këtij personi juridik;

është kompetenca e një personi (ose personave që veprojnë bashkërisht) për të siguruar që punët e palës tjetër do të kryhen drejtpërdrejtë ose tërthorazi në përputhje me vullnetin e atij personi (ose personave që veprojnë bashkërisht) qoftë nëpërmjet:

(a) në rastin e një shoqërie, që është pronari përfitues i më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të kapitalit të emetuar të shoqërisë ose të drejtave të votës në shoqëri, ose që ka të drejtë të emërojë ose shkarkojë shumicën e drejtorëve ose ndryshe të kontrollojë votat në mbledhjet e Këshillit të kësaj shoqërie nëpërmjet të drejtave të parashikuara në statut, marrëveshje të asamblesë së përgjithshme ose në çdo dokument tjetër që rregullon punët e kësaj shoqërie;

(b) në rastin e një ortakërie, që është pronari përfitues i më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të kapitalit të kësaj ortakërie ose që ka të drejtë të kontrollojë përbërjen ose votat e shumicës së drejtuesve të kësaj ortakërie nëpërmjet kompetencave të parashikuara në marrëveshjen e ortakërisë ose çdo dokument tjetër që rregullon punët e kësaj ortakërie,

dhe “e kontrolluar” do të interpretohet sipas rastit. Për këtë qëllim, “personat që do të veprojnë në bashkëpunim”, në lidhje me një person, janë personat që bashkëpunojnë aktivisht sipas një marrëveshjeje ose mirëkuptimi (qoftë formale ose jo formale) për të marrë, ruajtur dhe forcuar kontrollin e këtij personi.

“Barrë”

është, çdo hipotekë, barrë, peng, opSION, kufizim, e drejtë refuzimi, e drejtë parablerje, e drejtë e palës së tretë ose interes ose barrë tjetër apo e drejtë interesi e çdo lloji, ose çdo marrëveshje tjetër që ka të njëjtin efekt përfshirë çdo



SBS ADRIA SH.A.

SELECT BUNKERING SERVICES

	gjë të ngjashme me sa më sipër sipas ligjeve të çdo juridiksioni.
“Viti financiar”	ka kuptimin e dhënë në nenin 21.
“Asambleja e Përgjithshme”	është asambleja e përgjithshme e aksionarëve të shoqërisë.
“Drejtori ekzekutiv”	është Drejtori ekzekutiv (Administratori) i shoqërisë, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
“Qendra Kombëtare e Biznesit”	është <i>Qendra Kombëtare e Biznesit</i> , institucion publik shqiptar, i themeluar me ligjin Nr. 131, datë 26.11.2015 (“Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”) dhe i ndryshuar rast pas rasti.
“Person i kufizuar”	është çdo person ose subjekt për të cilin është rënë dakord nga palët; ose, sipas gjykimit të arsyeshëm të aksionarëve të tjerë, është ose ka qenë çdo filial i tij, i cili shkel ligjet kundër mitmarrjes, sanksioneve, pastrimit të parave a të tjera dhe me të cilin mund t’u shkaktojë dëm material reputacionit të aksionarit, ndonjë dege të tij apo shoqërisë.
“Palë e tretë”	është pala e tretë në mirëbesim, e cila nuk është aksionar, filial ose person i lidhur i ndonjë prej aksionarëve.
“SBS GmbH”	është SBS Select Bunkering Services GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar e që funksionon sipas ligjeve të Gjermanisë, me numër regjistrimi HRB171271 dhe seli në adresën Jungfernstieg 34, 20354 Hamburg, Gjermani.
“Aksionarët”	janë SBS GmbH, z. Qazim Qazimi dhe znj. Eda Spahiu, apo në të ardhmen, çdo person fizik a juridik i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të shoqërisë si zotërues aksionesh në shoqëri dhe “aksionari” do të interpretohet sipas rastit.
“Mbledhja e shtyrë e aksionarëve”	ka kuptimin e dhënë në nenin 14.3.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

Neni 2 – Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është themeluar si shoqëri aksionare në Republikën e Shqipërisë dhe është e organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3 - Selia


- 3.1 Selia e shoqërisë është: Rr. Reshit Çollaku, Pallati Classic Construction, H. 2, Kati 2, Nr. 12, Njësia Bashkiake nr. 10, Tiranë, Shqipëri.

Neni 4 – Emri dhe kohëzgjatja

- 4.1 Emri i shoqërisë është "SBS Select Bunkering Services – Adria" SHA. Emri tregtar i shoqërisë do të jetë SBS – Adria SHA.
- 4.2 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5 – Objekti i aktivitetit

- 5.1 Aktiviteti i shoqërisë do të përfshijë, por pa u kufizuar, sa më poshtë vijon:
- (i) tregtimin me shumicë të naftës bruto dhe të nënprodukteve të saj; dhe
 - (ii) tregtimin e karburantit për anije dhe furnizimin e mjeteve lundruese në port e në radë.
- 5.2 Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur, shoqëria mund të:
- kryejë çdo aktivitet me aktive të prekshme dhe të paprekshme, si dhe veprimtari tregtare, qiradhënie ose hipotekore që mund të konsiderohen të përshtatshme ose të nevojshme për të përmbushur qëllimin e shoqërisë;
 - blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe interesa në shoqëri të tjera që kanë një qëllim të ngjashëm me shoqërinë, në Shqipëri ose jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe
 - ushtrojë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i përshtatshëm ose i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit të shoqërisë.
- 5.3 Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo biznes ose aktivitet tjetër që konsiderohet nga Asambleja e Përgjithshme se është zhvilluar ose kryer në mënyrë të përshtatshme ose të favorshme në lidhje me ndonjë nga objektet e mësipërme ose që është llogaritur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të rritur vlerën ose për ta bërë më fitimprurës



SBS ADRIA SH.A.

SELECT BUNKERING SERVICES

cilindo nga aktivitetet e shoqërisë, pasurinë ose të drejtat e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe në përgjithësi të kryejë të gjitha veprimet e tjera që shoqëria mund të gjykojë si të rastësishme ose të favorshme për arritjen e objektivave të mësipërm ose ndonjë prej tyre.

KAPITULLI II

KAPITALI; AKSIONET DHE TË DREJTAT

Neni 6 – Kontributet

- 6.1 Kapitali fillestar i regjistruar i shoqërisë është 3.500.000,00 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë , i ndarë në 350 (treqind e pesëdhjetë) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë secili (më tutje referuar bashkërisht si "aksione"). Kapitali fillestar do të derdhet plotësisht në para para regjistrimit, në llogarinë bankare të përkohshme të shoqërisë.
- 6.2 Struktura aksionare e shoqërisë është si më poshtë:

Aksionarët	Nr. i aksioneve të zakonshme	Vlera totale e shprehur në kapital	Përqindje e kapitalit aksionar
SBS GmbH	176	1.760.000 lekë	~50,30 %
Qazim Qazimi	87	870.000 lekë	~24,85 %
Eda Spahiu	87	870.000 lekë	~24,85 %

Neni 7 – Të drejtat

- 7.1 Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre:
- (i) të drejtën për t'u njoftuar si dhe për të marrë pjesë e votuar në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë dhe për të ushtruar çdo të drejtë tjetër lidhur me aksionet sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare; dhe
 - (ii) të drejtën për të marrë dividendë ose shpërndarje të tjera në përpjesëtim me vlerën e aksioneve në kapitalin aksionar të shoqërisë (nëse Asambleja e Përgjithshme vendos kështu).



SBS ADRIA SH.A.


SELECT BUNKERING SERVICES

Neni 8 – Regjistri i aksionarëve

- 8.1 Drejtori ekzekutiv do të mbajë një regjistër në të cilin regjistrohen emrat dhe adresat e të gjithë aksionarëve, i cili të përmbajë datën e blerjes së aksioneve, numrin, klasën e emërimit të tyre (nëse ka) dhe shumën e paguar për çdo aksion. Emrat dhe adresat e palëve që kanë barra lidhur me aksionet e shoqërisë duhet të regjistrohen në regjistër, së bashku me datën kur e kanë fituar të drejtën dhe duke përkrahur se cilat të drejta bashkëngjitur aksioneve u janë dhënë atyre.
- 8.2 Aksionarët dhe palët e tjera, të dhënat e të cilëve regjistrohen sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t'i japin drejtorit ekzekutiv informacionin e kërkuar të kontaktit brenda kohës së duhur. Nëse njoftohet një adresë elektronike, qoftë dhe me qëllimin për t'u regjistruar në regjistrin e Asamblesë së Përgjithshme, atëherë njoftimi përbën edhe pëlqim për t'i marrë të gjitha njoftimet e deklaratat lidhur me thirrjen e mbledhjeve, në formë elektronike përmes adresës së dhënë.
- 8.3 Regjistri duhet të përditësohet rregullisht. Çdo çlirim nga detyrimi i dhënë për pagesat ende të pakryera duhet të regjistrohet në të.
- 8.4 Drejtori ekzekutiv duhet ta vërë në dispozicion regjistrin në zyrën e shoqërisë për inspektim nga aksionarët, uzufuktarët dhe pengmarrësit të cilët kanë fituar të drejta me ose pa posedim mbi aksionet. Me paraqitje kërkesë, drejtori ekzekutiv duhet t'u sigurojë personave të përmendur në këtë paragraf ekstrakte të regjistrit.

Neni 9 – Kufizimet lidhur me shitjen e aksioneve

- 9.1 Mbështetur në paragrafin 2 të këtij neni, asnjë aksionar nuk do të bëjë apo të pranojë të bëjë asgjë nga sa më poshtë, pa miratimin paraprak me shkrim me shumicë votash (>50%) të Asamblesë së Përgjithshme:
- të shesë, dhurojë, caktojë, transferojë ose shesë në ndonjë mënyrë tjetër, apo të japë ndonjë të drejtë lidhur me ndonjë prej aksioneve ose ndonjë interes ligjor apo me përfitim për ndonjë prej aksioneve të tij;
 - të krijojë ose të lejojë ekzistencën e ndonjë barre mbi ndonjë prej aksioneve të tij ose ndonjë interesi në ndonjë prej aksioneve të tij, me kusht që SBS GmbH të mund të lërë peng ose në ndonjë mënyrë tjetër të japë garanci lidhur me aksionet e zotëruara prej saj në favor të një institucioni financiar për të siguruar çdo huamarrje nga SBS GmbH pa pasur nevojë për pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme;



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- c. të krijojë ndonjë *trust* lidhur me ose të japë ndonjë interes për ndonjë prej aksioneve të tij;
 - d. të lidhë ndonjë marrëveshje, të ndërmarrë ndonjë angazhim ose mirëkuptim lidhur me votat ose të drejtën për të marrë dividendë ose çdo të drejtë tjetër që i bashkëngjitet ndonjë prej aksioneve të tij;
 - e. të lejojë cilindo person të kufizuar të përfitojë ndonjë interes, drejtpërdrejt a jo, nëpërmjet një ose më shumë filialeve, apo nëpërmjet ndonjë marrëveshjeje që jep një interes ose jep një përfitim i cili rrjedh nga një interes në vetvete ose në ndonjë shoqëri.
- 9.2 Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të zbatohet për asnjë transferim të kryer sipas nenit 10 më poshtë.

Neni 10 – Transferimet e lejuara të aksioneve

10.1 Transferimet në shoqëritë e lidhura

Çdo aksionar mund t'ia transferojë në çdo kohë disa a të gjitha aksionet e tij një shoqërie të lidhur, duke u dhënë njoftim paraprak me shkrim aksionarëve të tjerë, i cili t'i dërgohet dhe shoqërisë.

10.2 Opsioni i shitjes

- a. Për sa kohë SBS GmbH është aksionar në shoqëri, ka të drejtën për t'u kërkuar në çdo kohë aksionarëve të tjerë blerjen e të gjitha aksioneve të saj në shoqëri ("aksionet e opsionit të shitjes") sipas kushteve të opsionit të shitjes që paraqiten në vijim.
- b. Opsioni i shitjes ushtrohet vetëm nga SBS GmbH, duke u dhënë aksionarëve të tjerë njoftim për ushtrimin e tij, sipas nenit 23, i cili të përfshijë:
 - datën kur jepet njoftimi për ushtrimin e opsionit të shitjes;
 - deklarin e ushtrimit të opsionit nga SBS GmbH;
 - çmimin e rënë dakord për opsionin e shitjes, i cili përcaktohet sipas formulës Shuma = fitimi vjetor përpara tatimit (për vitin e fundit të plotë financiar) X 5;
 - datën brenda së cilës duhet kryer ushtrimi i opsionit, e cila të mos jetë më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) e më shumë se 45 (dyzetë e pesë) pas njoftimit të ushtrimit të së drejtës, përveçse kur SBS GmbH fillon procedurën e vlerësimit (sipas parashikimeve të paragrafit d të këtij neni), në të cilin rast ky afat pezullohet deri sa të ketë përfunduar a të konsiderohet i përfunduar vlerësimi; dhe
 - nënshkrimin e SBS GmbH ose në emër të saj.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- c. Opsioni i shitjes mund të ushtrohet vetëm për të gjitha aksionet e opsionit të shitjes.
- d. Nëse SBS GmbH konsideron se çmimi i përcaktuar sipas paragrafit b të këtij neni nuk pasqyron vlerën e vërtetë të aksioneve të opsionit të shitjes, atëherë ka të drejtën që të fillojë procedurën e vlerësimit të tyre, duke pajtuar një vlerësues të pavarur që të jetë i pranueshëm për aksionarët e tjerë, i cili t'ua përcaktojë vlerën. Në rastet kur aksionarët nuk bien dakord të caktojnë vlerësuesin e pavarur brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga marrja e njoftimit për ushtrimin e opsionit, secili aksionar cakton vlerësuesin përkatës të pavarur brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja e njoftimit për ushtrimin e opsionit. Vlerësuesit do t'u paraqitin palëve vlerat e përlogaritura përkatëse brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve pune nga caktimi i tyre e në çdo rast jo më vonë se 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditëve pune pas marrjes së njoftimit për ushtrimin e opsionit. Në qoftë se vlerat e përlogaritura përkatëse ndryshojnë më pak se 10 (dhjetë) për qind nga përlogaritja më e lartë, atëherë vlera e aksioneve të opsionit të shitjes do të përcaktohet sipas mesatares së të gjitha vlerave të përlogaritura. Në rast se ndryshimi mes përlogaritjeve përkatëse është i barbartë me ose më shumë se 10 (dhjetë) për qind, atëherë vlera e aksioneve të opsionit të shitjes do të përcaktohet sipas mesatares së 2 (dy) përlogaritjeve më të larta. Përcaktimi i çmimit sipas kësaj procedure është përfundimtar dhe detyrues për palët. Në rastet kur vlerësuesi është në gjendje të japë vetëm nivelin ku qëndron përlogaritja e vlerës, vlerë e përlogaritur do të konsiderohet mesatarja e vlerës më të ulët dhe më të lartë të dhënë në nivelit në fjalë. Vlerësues të pranueshëm sipas parashikimeve të këtij neni janë auditues të njohur ndërkombëtarisht, si PricewaterhouseCoopers, Ernst & Young, Deloitte, KPMG, Grant Thornton e Mazars, të cilët të kenë përvojë të mëparshme vlerësimi të aktiviteteve të krahasueshme me të shoqërisë dhe të mos kenë interesa financiare a të tjerë ndaj ndonjë aksionari.
- e. Aksionarët e tjerë kanë përgjegjësi të përbashkët e veçantë për të përmbushur detyrimet sipas këtij neni. Në rast mosblerjeje të aksioneve të opsionit të shitjes, u kërkohet pagimi i vlerës së tyre si gjobë për mospërmbushjen e detyrimeve e për të mbuluar dëmet, kostot e shpenzimet shtesë që rrjedhin prej kësaj të fundit.

Neni 11 – Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 11.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- 11.2 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në të gjitha mënyrat dhe sipas procedurave të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare ose vendimi i Asamblesë, për aq sa është në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 11.3 Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtë të marrin pjesë në zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit aksionar të shoqërisë, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

KAPITULLI III

STRUKTURA E SHOQËRISË

Neni 12 – Struktura e shoqërisë

12.1. Shoqëria është e strukturuar si shoqëri aksionare me një nivel dhe me këto organe shoqërie:

- a. Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve;
- b. Këshilli i Administrimit; dhe
- c. Drejtori ekzekutiv.

Neni 13 – Asambleja e Përgjithshme

13.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i shoqërisë dhe ka të drejtë të marrë vendime për të gjitha çështjet e saj në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë vlefshmërinë e çdo vendimi të Këshillit të Administrimit dhe, sipas nevojshme, t'i anulojë ato në rast papajtueshmërie me statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

13.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshimet në statut;
- c. emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
- d. emërimi dhe shkarkimi i audituesve të pavarur dhe likuiduesve;



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- e. miratimi i skemës së shpërblimit të drejtorit ekzekutiv, anëtarëve të Këshillit të Administrimit, audituesve dhe likuiduesve;
 - f. miratimi i pasqyrave vjetore të llogarive dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g. shpërndarja e fitimeve vjetore;
 - h. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - i. pjesëtimi i aksioneve dhe anulimi i tyre;
 - j. ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta; ;
 - k. përfaqësimi i shoqërisë përpara gjykatës dhe në procedura të tjera kundrejt organeve drejtuese;
 - l. ristrukturimi dhe prishja e shoqërisë;
 - m. miratimi i rregullave të veta procedurale.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çdo çështje shtesë e cila nuk është qartas kompetencë e ndonjë organi tjetër sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij statuti.

Neni 14 - Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

Këshilli i Administrimit ose drejtori ekzekutiv mund ta thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në çdo kohë. Në çdo rast, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se qershori i vitit përkatës për të diskutuar, shqyrtuar dhe miratuar pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Aksionarët e mbajnë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në një vend të përcaktuar nga personi/organi i cili e thërret mbledhjen, por duke i dhënë mundësinë secilit aksionar të marrë pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike sipas nenit 14.5 më poshtë.

14.2 Njoftimi i mbledhjes së Asamblesë të Përgjithshme

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme u njoftohet me shkrim aksionarëve të paktën para 21 (njëzetë e një) ditëve kalendarike nga mbajtja e saj, përmes postës së regjistruar ose emailit me faturë dorëzimi, me përjashtim të rasteve kur aksionarët miratojnë me shkrim një afat më të shkurtër njoftimi dhe mbledhjeve të shtyra të Asamblesë. Njoftimin e shoqëron rendi i ditës së mbledhjes, i cili përmban shpejgime të hollësishme të të gjitha çështjeve për diskutim, si dhe kopje të dokumenteve përkatëse e projektvendimeve që do të parashtrohen.




SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

14.3 Kuorumi i mbledhjes së Asamblesë të Përgjithshme

Të gjitha veprimet e të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme kërkojnë pjesëmarrjen në mbledhje të një kuorumi prej të paktën 50 (pesëdhjetë) për qind të aksioneve me të drejtë vote të emetuara nga shoqëria. Mosarritja e kuorunit brenda 60 (gjashtëdhjetë) minutash nga hapja e mbledhjes ose humbja e kuorunit gjatë mbledhjes, shpie menjëherë në shtyrjen e mbledhjes dhe thirrjen e saj sërish, ditën e parë të punës pas 5 (pesë) ditësh kalendarike nga data e shtyrjes së saj, përveçse kur të gjithë aksionarët bien dakord me shkrim për ta shtyrë në afat tjetër. Aksionarët që nuk morën pjesë njoftohen për mbledhjen e shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme.

14.4 Votimi në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- a. Kryetarin e mbledhjes së Asamblesë e propozon SBS GmbH dhe e emërojnë me shumicë votash aksionarët pjesëmarrës në mbledhje. Sekretarin e mbledhjes së Asamblesë e propozon kryetari dhe e emërojnë me shumicë votash aksionarët pjesëmarrës në mbledhje.
- b. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicë të thjeshtë votash, me përjashtim të vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) për qind të aksionarëve pjesëmarrës në mbledhje sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këtij statuti, siç janë ndryshimi i statutit, shpërndarja e fitimeve, rritja a zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, ristrukturimi i shoqërisë dhe prishja e saj. Sipas rastit, shumica e thjeshtë dhe e cilësuar përcaktohen në përputhje me të drejtat e votës që u bashkëlidhen aksioneve të aksionarëve pjesëmarrës në mbledhje, me kusht që të mos numërohen votat abstenuese.
- c. Procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme e nënshkruajnë kryetari dhe sekretari i mbledhjes. Ekstraktet e vendimeve të miratuara në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që duhen depozituar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i përgatit Kryetari dhe, sipas nevojës, i nënshkruajnë të gjithë aksionarët pjesëmarrës e që kanë votuar në mbledhje. Nëse ndonjë nga aksionarët refuzon ta nënshkruajë brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e ekstraktit, ky i fundit do të konsiderohet ekstrakt i vërtetë i vendimeve të marra në mbledhje me nënshkrimin e vetëm të kryetarit dhe kundërnënshkrimin e sekretarit të mbledhjes.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

14.5 Pjesëmarrja në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Aksionari mund të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes mjeteve të tjera të komunikimit, si thirrjet telefonike, konferencat video etj, me kusht që këto t'u mundësojnë të gjithë pjesëmarrësve dëgjim e të folur të lirshme gjatë gjithë mbledhjes. Aksionarët që marrin pjesë përmes mjeteve të tjera të komunikimit do të konsiderohen sikur janë pjesëmarrës fizikë në mbledhje, ndaj ata do të numërohen në kuorum dhe do të kenë të drejtë vote.

14.6 Vendndodhja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

Vendndodhja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet me vendim të aksionarëve, me përjashtim të rasteve kur pjesëmarrësit nuk janë në të njëjtin vend, në të cilat mbledhja do të konsiderohet e mbajtur në selinë e shoqërisë.

14.7 Vendimi me shkrim i aksionarëve

Aksionarët mund të marrin vendim me shkrim, pa e thirrur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, me kusht që të gjithë aksionarët të votojnë pro vendimit. Vendimi me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme i njoftohet në formë shkresore të gjithë aksionarëve. Pavarësisht dispozitave e parashikimeve të tjera të këtij statuti, vendimi me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme miratohet vetëm nëse secili aksionar ka votuar pro tij dhe ka nënshkruar një a disa kopje të vendimit. Pas miratimit, të gjitha vendimet me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme trajtohen sikur të jenë vendime të marra në mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe këtë statut.

Neni 15 – Këshilli i Administrimit

- 15.1 Shoqëria do të administrohet nga Këshilli i Administrimit i cili është organi ekzekutiv i Shoqërisë (modeli me një nivel). Anëtarët e Këshillit emërohen për një mandat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, siç tregohet në vendimin për emërimin e tyre. Këshilli ka të drejtë të ushtrojë secilën nga kompetencat sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe kompetencat shtesë të parashikuara në këtë statut.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

15.2 Kompetencat e Këshillit të Administrimit

Përveç kompetencave që i janë dhënë në mënyrë të qartë Këshillit sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Këshilli gjithashtu ka të drejtë të zgjidhë çdo çështje të përcaktuar në Shtojcën ("çështjet e rezervuara të Këshillit") e këtij statuti dhe që mund të ndryshohen herë pas here me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme marrë me shumicë të thjeshtë. Çdo ndryshim në çështjet e rezervuara të Këshillit nuk do të interpretohet si një ndryshim i këtij Statuti.


15.3 Përveç nëse një shumicë më e madhe kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, çdo çështje në kompetencën e Këshillit do të miratohet nga:

- (i) një vendim i Këshillit i marrë me shumicë të thjeshtë në një mbledhje të Këshillit me numrin e duhur të pjesëmarrësve për të marrë vendime; ose
- (ii) një vendim unanim me shkrim i të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Miratimi në përputhje me këtë nen nuk kërkohet për asnjë çështje që është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij statuti dhe është miratuar tashmë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të thjeshtë, përveç rasteve kur kërkohet shumica e cilësuar në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

15.4 Përbërja e Këshillit

- (a) Këshilli përbëhet nga një numër i tillë anëtarësh të Këshillit që emërohen rast pas rasti në përputhje me këtë statut dhe në përputhje me dispozitat e detyrueshme të ligjit për shoqëritë tregtare, por në çdo rast nuk mund të ketë më pak se pesë (5) anëtarët. Secili aksionar me anë të njoftimit dërguar aksionarit tjetër mund t'i kërkojë që të caktojë atë numër të anëtarëve të Këshillit që ka të drejtë të emërojë në përputhje me nenin 15.4(b) me qëllim që të sigurojë që shoqëria është në pajtueshmëri ligjin.
- (b) SBS GmbH do të ketë të drejtë të emërojë 3 (tre) anëtarë të Këshillit në Këshillin e Administrimit dhe çdo dy aksionarët e pakicës do të emërojnë secili 1 (një) anëtar të Këshillit. Çdo aksionar do të sigurojë emërimin e çdo anëtari të Këshillit të emëruar në këtë mënyrë nëpërmjet mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme sa më shpejt që të jetë e mundur.
- (c) Çdo aksionar do të ketë të drejtë të kërkojë largimin e çdo anëtari të Këshillit të emëruar nga ai rast pas rasti duke njoftuar aksionarët e tjerë për këtë, dhe secili



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

aksionar do të sigurojë largimin e këtyre anëtarëve të Këshillit sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit.

15.5 Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit

- a. Çdo emërim ose largim i një anëtari të Këshillit të emëruar nga një aksionar do të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme ose nëpërmjet vendimit me shkrim të aksionarëve, dhe një emërim ose shkarkim i tillë do të hyjë në fuqi menjëherë pas miratimit të një vendimi të tillë ose vendimit me shkrim.
- b. Në rast të një pozicioni të lirë, drejtori ekzekutiv ose çdo anëtar i Këshillit duhet të njoftojë menjëherë aksionarin që kish emëruar ish-anëtarin dhe aksionarët për të bërë zëvendësimin në Këshillin e Administrimit.
- c. Çdo aksionar që propozon heqjen e një anëtari të këshillit në përputhje me kushtet e këtij statuti, do të dëmshpërblejë aksionarët e tjerë dhe Shoqërinë sipas kërkesës kundër të gjitha humbjeve, detyrimeve dhe kostove që ky person mund të ketë si rezultat, ose në lidhje me, çdo pretendim nga ky anëtar i Këshillit për shkarkim të gabuar ose të padrejtë, shkurtim ose ndryshe që rrjedh nga ndërprerja e detyrës së këtij anëtari të Këshillit.

15.6 Kryetari i Këshillit

- a. Për sa kohë që SBS GmbH ka të drejtë të emërojë të paktën një anëtar Këshilli në përputhje me nenin 15.4 (b), SBS GmbH do të ketë të drejtë të propozojë kryetarin e Këshillit, që do të emërohet nga Këshilli me shumicë të thjeshtë. Kryetari do të shërbejë si drejtues i mbledhjeve të Këshillit sa herë që ai është i pranishëm dhe do të ketë një votë vendimtare.
- b. Për aq kohë sa dy aksionarët e pakicës kanë të drejtë të emërojnë të paktën një anëtar të Këshillit në përputhje me nenin 15.4 (b), ata do të kenë të drejtë të propozojnë emërimin e zëvendëskryetarit të Këshillit, që do të emërohet nga Këshilli me shumicë të thjeshtë. zëvendëskryetari do të kryejë funksionet e kryetarit në çdo mbledhje në të cilën kryetari nuk është i pranishëm dhe ka një votë vendimtare.
- c. Nëse kryetari ose zëvendëskryetari heq dorë nga detyra si anëtar i Këshillit gjatë mandatit të tij si kryetar ose zëvendëskryetar (sipas rastit), SBS GmbH ose ndonjë



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

nga aksionarët e pakicës (sipas rastit) do të ketë të drejtë të propozojë një anëtar tjetër të Këshillit të emërohet kryetar ose zëvendëskryetar (sipas rastit) për pjesën e mbetur të mandatit.

Neni 16 – Procedurat e Këshillit

16.1 Thirrja e mbledhjeve të Këshillit

Çdo anëtar i Këshillit mund të thërrasë një mbledhje të Këshillit në çdo kohë. Anëtarët e Këshillit do t'i mbajnë mbledhjet e Këshillit në selinë e shoqërisë ose në një vend të tillë që të gjithë anëtarët e Këshillit mund të përcaktojnë ose me mjete elektronike. Këshilli do të mbledhet të paktën katër herë në vit dhe, përveç nëse të gjithë anëtarët e Këshillit bien dakord ndryshe me shkrim, të paktën një herë në tre muaj.

16.2 Njoftimi i mbledhjeve të Këshillit

Çdo anëtar i Këshillit do t'i jepet një njoftim me shkrim të paktën 5 (pesë) ditë përpara për një mbledhje të Këshillit, përveç nëse anëtarët e Këshillit miratojnë me shkrim një periudhë më të shkurtër njoftimi. Një njoftim i tillë do të shoqërohet me rendin e ditës që identifikon në hollësi të arsyeshme çështjet që do të diskutohen në mbledhje së bashku me kopjet e çdo dokumenti përkatës që do të diskutohet në mbledhje.

16.3 Kuorumi në mbledhjet e Këshillit

- a. Në varësi të nenit 16.3b., kuorumi për miratimin e çështjeve në çdo mbledhje të Këshillit (përfshirë një mbledhje të shtyrë të Këshillit) do të jetë të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit me kusht që 2 (dy) anëtarë të Këshillit të SBS GmbH të jenë gjithmonë të pranishëm, një prej të cilëve duhet të jetë gjithmonë kryetari. Nëse kuorumi nuk është i pranishëm brenda 60 minutave nga koha kur mbledhja duhet të kishte filluar ose nëse gjatë mbledhjes nuk ka më kuorum, mbledhja do të shtyhet dhe do të mbledhet në të njëjtën kohë dhe vend 5 (pesë) ditë pune menjëherë pas datës së propozuar të mbledhjes, përveç nëse të gjithë anëtarët e Këshillit bien dakord me shkrim për një periudhë tjetër ("mbledhja e shtyrë e Këshillit"). Njoftimi për mbledhjen e shtyrë të Këshillit do t'u jepet anëtarëve të Këshillit që mungojnë.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- b. Për sa kohë që SBS GmbH është aksionar në shoqëri, nuk do të krijohet kuorumi për asnjë mbledhje të Këshillit, përveç nëse anëtarët e emëruar nga SBS GmbH janë të pranishëm në mbledhje në përputhje me nenin 16.3(a).
- c. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të ftojë, sipas gjykimit të tij, deri në dy (2) persona në çdo mbledhje të Këshillit. Kuptohet që këta persona nuk kanë të drejtë të votojnë në mbledhje të tilla.

16.4 Procesverbali dhe vendimet e Këshillit

Anëtarët e Këshillit marrin vendime duke i miratuar ato. Procesverbali i mbledhjes mbahet dhe nënshkruhet nga kryetari. Ekstraktet e vendimeve të miratuara në mbledhje të Këshillit të kërkuara për depozitim do të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të pranishëm në një mbledhje të Këshillit. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit refuzon të nënshkruajë ekstraktin, ai do të konsiderohet si një ekstrakt i vërtetë i vendimeve të miratuara në mbledhje me nënshkrimin e vetëm të kryetarit.

16.5 Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit

Një anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë në një mbledhje të Këshillit me anë të telefonit, videokonferencës ose formës së ngjashme të pajisjeve të komunikimit që u mundëson të gjithë personave që marrin pjesë në mbledhje të dëgjojnë dhe flasin me njëri-tjetrin gjatë gjithë mbledhjes. Një person që merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet të jetë i pranishëm personalisht në mbledhje dhe numërohet në kuorum dhe ka të drejtë vote.

16.6 Vendndodhja e mbledhjeve të Këshillit

Nëse të gjithë anëtarët e Këshillit që marrin pjesë në një mbledhje nuk janë në të njëjtin vend dhe nëse nuk bien dakord ndryshe, atëherë mbledhja do të konsiderohet si e zhvilluar në selinë të shoqërisë.

16.7 Vendimet me shkrim të Këshillit

Këshilli i Administrimit mund të vendosë nëpërmjet vendimit me shkrim pa thirrur mbledhjen e Këshillit, me kusht që të gjithë anëtarët e Këshillit të votojnë në favor të një vendimi të tillë. Njoftimi për një vendim të propozuar të Këshillit duhet t'i jepet me shkrim secilit anëtar të Këshillit. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtij statuti, një vendim



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

me shkrim i Këshillit miratohet kur secili nga anëtarët e Këshillit ka votuar në favor të një vendimi të tillë dhe ka nënshkruar një ose më shumë kopje të saj, dhe me kusht që asnjë anëtar i Këshillit të mos kërkojë diskutime rreth vendimit të propozuar. Pasi të jetë miratuar një vendim me shkrim i Këshillit, ai do të trajtohet sikur të ishte një vendim i marrë në një mbledhje të Këshillit në përputhje me këtë statut.

Neni 17 – Drejtori ekzekutiv

17.1 Drejtori ekzekutiv

- a. Shoqëria do të ketë një ose më shumë drejtorë ekzekutivë, të cilët do të kenë kompetenca për të drejtuar bashkërisht aktivitetet e përditshme të shoqërisë në drejtimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të Këshillit të Administrimit. Në bazë të këtij drejtimi dhe mbikëqyrjeje, çështjet e rezervuara të Këshillit, nëse ka, Sstatutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, drejtori ekzekutiv do të ketë autoritetin për të drejtuar biznesin në çdo rrethanë në emër të shoqërisë.
- b. Drejtorët ekzekutivë, nëse emërohet më shumë se një i tillë, do të veprojnë bashkërisht dhe do të përfaqësojnë shoqërinë përpara palëve të treta, me kusht që të kërkohet miratimi paraprak me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit të Administrimit për çdo çështje në kompetencën e Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit të Administrimit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë statut ose që përbëjnë një çështje të rezervuar të Këshillit. Për qëllim përfaqësimi të shoqërisë, çdo veprim i drejtorit ekzekutiv që kërkon miratim paraprak me shkrim të Këshillit do të konsiderohet si i miratuar rregullisht nga Këshilli dhe në të mund të mbështeten palët e treta nëse shoqërohet me deklaratë me shkrim, konfirmim ose kundër-firmë të dyfishtë të vetëm kryetarit të Këshillit. Çdo drejtor ekzekutiv mund t'i delegojë me prokurë ndonjë nga kompetencat e tij drejtorëve të tjerë ekzekutivë ose ndonjë pale të tretë.
- c. Drejtori ekzekutiv është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të shoqërisë që ka marrë gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Kur drejtori ekzekutiv, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose me këtë statut, i shkakton shoqërisë një dëm material ose moral, ai mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.
- d. Kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të çdo drejtori ekzekutiv dhe çdo kufizim i tyre, mund të përcaktohen ose të ndryshohen me vendim të Këshillit të Administrimit të



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

shoqërisë të miratuar rast pas rasti dhe një ndryshim i tillë nuk do të interpretohet si ndryshim i këtij statuti të shoqërisë. Për më tepër, çështjet që përbëjnë çështje të rezervuara të Këshillit, nëse ka dhe nëse janë të zbatueshme, do të interpretohen si kufizim i kompetencave të drejtorëve ekzekutivë dhe do të regjistrohen si të tilla në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

- e. Shpërblimi i drejtorit ekzekutiv përcaktohet me vendim të Këshillit të Administrimit.
- f. Drejtori ekzekutiv emërohet për një periudhë ose një mandat jo më të gjatë se 3 (tre) vite, siç përcaktohet në vendimin për emërimin e tyre, me miratim nga Këshilli me shumicë të thjeshtë. Shkarkimi i drejtorit ekzekutiv vendoset me vendim të Këshillit të miratuar me shumicë të thjeshtë.
- g. Çdo përmendje e drejtorit ekzekutiv në këtë statut, duhet të interpretohet si referencë ndaj cilitdo prej drejtorëve ekzekutivë të shoqërisë, nëse është emëruar më shumë se një i tillë.

KAPITULLI IV


AUDITIMI DHE ÇËSHTJET FINANCIARE

Neni 18 – Kontabilisti

- 18.1 Shoqëria ka të paktën një kontabilist të përhershëm, i cili duhet të flasë dhe të shkruajë anglisht, i emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe që përmbush detyrat në lidhje me këtë pozicion.
- 18.3 Kontabilisti ruan konfidencialitetin e informacionit që merr gjatë ushtrimit të detyrave të tij profesionale dhe mban përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar shoqërisë për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të tij të gabuara.

Neni 19 – Audituesi

- 19.1 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë, me shumicë të thjeshtë, një auditues, për çdo vit financiar me kompetencat e mëposhtme, por jo vetëm:
 - të ndihmojë në mbajtjen e llogarive në mënyrë që të jenë në përputhje me parimet e kontabilitetit;



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- të përgatisë raportin e auditorit dhe dokumentet tjera në përputhje me dispozitat ligjore; dhe
- të informojë drejtorin ekzekutiv dhe Këshillin e Administrimit për çdo parregullsi të konstatuar në procedurat, aktivet ose llogaritë e shoqërisë ose në çdo çështje tjetër që lidhet me të dhënat financiare të shoqërisë.

Neni 20 – Librat e shoqërisë

- 20.1 Shoqëria do të mbajë libra dhe do të përgatisë dokumente që regjistrojnë llogaritë vjetore, pasqyrat financiare, bilanci, raportet financiare dhe çdo dokument tjetër të tillë, siç kërkohet me ligj.
- 20.2 Librat e Shoqërisë dhe pasqyrat financiare vjetore, bilanci dhe raportet financiare do të mbahen në gjuhën angleze dhe shqipe; dhe të shprehura në euro (EURO) dhe në lekë (LEKË).

Neni 21 – Viti financiar

- 21.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë financiar që përfshin periudhën kohore nga regjistrimi fillestar në Regjistrin Tregtar deri më 31 dhjetor.

Neni 22 – Rezerva

- 22.1 Të paktën 5% e fitimit neto pas zbritjes së humbjeve të viteve të mëparshme mbahet si rezervë e detyrueshme. Shpërndarja e fitimeve në rezervën e detyrueshme nuk është me e detyrueshme kur kjo rezervë arrin shumën e 1/10 (një të dhjetës pjesë) të kapitalit themeltar, por do të rifillojë në rast se rezerva e domosdoshme bie nën 1/10 (një të dhjetën pjesë) të kapitalit.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

KREU V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23 – Njoftimet

23.1 Një njoftim i dhënë sipas nenit 10:

- (a) duhet të jetë me shkrim në anglisht (ose të shoqërohet nga një përkthim i përgatitur siç duhet në anglisht);
- (b) do të dërgohet në vëmendje të personit dhe në adresën ose adresën e e-mailit, të dhënë në këtë statut (ose një adresë tjetër, email ose person që pala përkatëse mund t'i njoftojë palës tjetër); dhe
- (c) do të
 - (i) dorëzohet personalisht; ose
 - (ii) dërgohet me email me konfirmimin e marrjes në dorëzim; ose
 - (iii) dërgohet me letër porosi me kthim përgjigje ose me konfirmimin e dorëzimit; ose
 - (iv) (nëse njoftimi do të dërgohet me postë jashtë vendit nga i cili është dërguar) do të dërgohet me postë ajrore.

23.2 Adresat për dërgimin e njoftimit janë:

SET Select Energy GmbH

Jungfernstieg 34

20354 Hamburg

For the attention of: Alen Bejko

Email: a.bejko@set-energy.de

Qazim Qazimi

Rruga Skënderbeg 21

Tiranë, Shqipëri

Email: gaz_qazimi@yahoo.com



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

Eda Spahiu

Mak Albania Hotel

Sheshi Italia nr. 2

Tiranë, Shqipëri

Email: spahiueda18@gmail.com

23.3 Një njoftim konsiderohet se është marrë:

- (a) nëse dorëzohet personalisht, në momentin e dorëzimit; ose
- (b) në rastin e postës elektronike, në momentin e marrjes së konfirmimit të dorëzimit; ose
- (c) në rastin e letër porosisë me kthim përgjigje ose konfirmimit të dorëzimit, 48 orë nga data e postimit; ose
- (d) në rastin e postës ajrore, pesë ditë nga data e postimit; ose
- (e) nëse konsiderohet se marrja sipas paragrafëve të mëparshëm të këtij neni nuk është bërë brenda orarit të punës (që do të thotë nga ora 9.00 deri në orën 17.30 nga e hëna deri të premten, në një ditë që nuk është ditë pune), kur biznesi fillon punë në momentin e marrjes.

23.4 Për të vërtetuar shërbimin, mjafton të vërtetohet se njoftimi është dërguar me email në adresën e emailit të aksionarit ose, në rastin e postës, se zarfi që përmban njoftimin është drejtuar dhe postuar siç duhet.

Neni 24 – Likuidimi i shoqërisë

- 24.1. Pas vendimit për prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues dhe përcakton kompetencat e tyre dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për shoqëritë tregtare.
- 24.2. Likuiduesi ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare dhe ushtron kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të shoqërisë, të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

Neni 25 – Anëtarët e Parë të Këshillit të Administrimit

25.1. Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit të emëruar për një mandat 3 (tre) vjeçar do të jenë:

1. **Z. Alen Bejko**, me numër pasaporte BF4780915 dhe vendlindje në Tiranë, shtetas shqiptar, kryetar i Këshillit të Administrimit;
2. **Z. Qazim Qazimi**, me numër pasaporte BB6824028 dhe vendlindje në Elbasan, shtetas shqiptar, zëvendëskryetar i Këshillit të Administrimit;
3. **Znj. Zelfije Ademaj**, me numër pasaporte BR1178461 dhe vendlindje në Kukës, shtetase shqiptare, anëtare e Këshillit të Administrimit;
4. **Z. Andrej Vladimirovic Kim**, me numër pasaporte C1VH9ZR8W dhe vendlindje në Moskë, shtetas gjerman, anëtar i Këshillit të Administrimit;
5. **Z. Felix Alexander Andreae**, me numër pasaporte C73ZC7Z38 dhe vendlindje në Hamburg, shtetas gjerman, anëtar i Këshillit të Administrimit.

25.2 Nëse është e nevojshme, Asambleja e Përgjithshme do të konfirmojë çdo emërim të bërë në përputhje me këtë statut në mbledhjen e saj të parë.

Neni 26 – Drejtorët e parë ekzekutivë të shoqërisë

26.1 Drejtori i parë ekzekutiv i Shoqërisë i emëruar për një mandat 3 (tre) vjeçar është z. **Arlind Fida**, me numër pasaporte BG2432828 dhe vendlindje në Krujë, shtetas shqiptar.

26.2 Nëse është e nevojshme, Këshilli do të konfirmojë çdo emërim të bërë në përputhje me këtë nen në mbledhjen e tij të parë.

Neni 27 – Audituesi i parë

27.1 Audituesi i parë i shoqërisë emërohet **Z. Arjan Dhimetrika**, me numër letërnjoftimi 033989724 dhe vendlindje në Tiranë, shtetas shqiptar për një mandat 1 (një) vjeçar.

Neni 28 – Dispozita përfundimtare




SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

- 28.1 Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen për çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht me këtë statut.
- 28.2 Nëse ndonjë dispozitë e këtij statuti është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt sipas ligjeve të Shqipërisë, ajo do të konsiderohet e veçuar nga ky statut. Në një rast të tillë, aksionarët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zëvendësuar atë me një dispozitë të vlefshme dhe të detyrueshme, efekti i së cilës është sa më afër efektit të synuar dhe në rast se nuk arrihet marrëveshje, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 29 – Hyrja në fuqi

- 29.1. Ky statut do të hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe dhe do të hyjë në fuqi dhe do të bëhet i detyrueshëm pas nënshkrimit të tij nga Aksionarët. Versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi midis aksionarëve, në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dy versioneve.

Nënshkruar në Tiranë, më 6 dhjetor 2021




SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES


AKSIONARËT

Në emër të
SBS Select Bunkering Services GmbH


[Emri]

Qazim Qazimi

Francis RANCI (perfaqesues)


Qazim Qazimi


Eda Spahiu

Eda Spahiu




SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

SHTOJCA: ÇËSHTJET E REZERVUARA TË KËSHILLIT

Struktura e shoqërisë

1. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit ekzekutiv, si dhe çdo ndryshim i kompetencave të tij.
2. Çdo ndryshim në strukturën e rënë dakord të drejtimit të shoqërisë, duke përfshirë emërimin dhe shkarkimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit, shefit të Financave, shefit të Operacioneve.

Aktivitete biznesi

3. Lidhja, ndryshimi, zgjidhja ose heqja dorë nga çdo marrëveshje magazinimi ose furnizimi me afat me subjekte palë të treta me një vlerë totale mbi 50.000,00 euro (pa TVSH).
4. Kryerja e çdo shpenzimi kapital për çdo artikull ose projekt mbi 50.000,00 (pa TVSH).
5. Çdo pagesë e bërë nga ose në emër të shoqërisë, përveç atyre që lidhen me operacionet e zakonshme të aktivitetit të shoqërisë (të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në blerje malli, kosto transporti e sigurim) me vlerë më të madhe se 25.000,00 euro (pa TVSH).
6. Fillimi, zgjidhja ose rënia dakord për ndonjë procedurë ligjore, arbitrazhi ose tjetër mbi 50.000,00 euro (përveç rikuperimit të borxhit gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare).
7. Kryerja e ndonjë marrëveshjeje me ndonjë autoritet tatimor ose ngritja e ndonjë pretendimi, mospranimi, dorëzimi, zgjedhja ose miratimi mbi 10.000,00 euro për qëllime tatimore në lidhje me shoqërinë ose biznesin e saj.
8. Lidhja, zgjidhja, ndryshimi, heqja dorë ose shkelja e ndonjë marrëveshjeje ose kontrate me shefin e Financës ose shefin e Operacioneve, miratimin ose ndryshimin e çdo politike shpërblimi për shefin e Financës ose shefin e Operacioneve ose ndryshimin e shpërblimit të tyre ose përfitimeve të tjera.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

9. Çdo çështje në të cilën një Anëtar i Këshillit ose Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë është i interesuar ose ku ai ka, ose mund të ketë, një konflikt interesi.

Financa

10. Shoqëria merr ndonjë financim nga palët e treta mbi 100.000,00 euro, përveçse nga shoqëritë e lidhura.

11. Shoqëria krijon një detyrim ose garanci tjetër mbi ndonjë nga aktivet ose pronat e saj mbi 100.000,00 euro në total.

12. Shoqëria i jep ndonjë hua ose paradhënie mbi 10.000,00 euro ndonjë personi.

Praktika dhe politikat e biznesit

13. Miratimi ose ndryshimi i çdo politike biznesi të shoqërisë (duke përfshirë politikat në lidhje me mjedisin, punësimin, shëndetin dhe sigurinë).

Punësimi dhe përfitime të tjera

14. Lidhja, zgjidhja, ndryshimi, heqja dorë ose shkelja e ndonjë marrëveshjeje ose kontrate me çdo punonjës ose këshilltar të shoqërisë, kontrata e të cilit nuk mund të zgjidhet me njoftim tre muaj përpara ose më pak ose që paguhet mbi 25.000,00 euro në vit, ose ndryshimin e shpërblimit ose përfitimeve të tjera të çdo personi të tillë.

15. Vendimet thelbësore në lidhje me një pjesë thelbësore të fuqisë punëtore të Shoqërisë.

16. Krijimi ose ndryshimi i çdo skeme të ndarjes së fitimit, të drejtës për aksion, bonusit ose skemë tjetër nxitëse të çdo natyre për drejtorët dhe punonjësit e Shoqërisë.

17. Krijimi ose ndryshimi i ndonjë skeme pensioni ose dhënia e ndonjë të drejte të skemës së pensioneve për ndonjë drejtor (aktual ose të mëparshëm) ose punonjës të shoqërisë.



SBS ADRIA SH.A.
SELECT BUNKERING SERVICES

**ARTICLES OF INCORPORATION AND ARTICLES OF ASSOCIATION
of
SBS Select Bunkering Services – Adria SH.A.**

CHAPTER I

**DEFINITIONS; FORM; REGISTERED OFFICE;
NAME; DURATION; OBJECT**

Article 1- Name and Definitions

1.1 In these Articles:

"Affiliate"

means, in relation to a person, any holding company, parent undertaking, subsidiary, subsidiary undertaking or any other subsidiaries or subsidiary undertakings of any such holding company or parent undertaking and any other person which controls, is controlled by or is under common Control with such person.

"Articles"

means these articles of incorporation or articles of association of the Company, as amended or superseded from time to time.

"Associated Company"

means, in relation to a person, any holding company in relation to which such person is a wholly owned subsidiary and any other wholly owned subsidiary of any such holding company

"Auditor"

means the auditor(s) of the Company from time to time.

"Board"

means the Company Board of Directors as constituted from time to time in accordance with Article 154 et seq. of the Company Law.

"Board Member"

